


per pakiten



Seanca plenare
Seanca nr. 2003/21
Prishtinë, më 10 dhe 11 korrik 2003, ora 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla plenare

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi Nexhat Daci, kryetar i Kuvendit të Kosovës, kurse bashkëkryesues ishte Nafije Gash, anëtare e Kryesisë.

Kryesuesi konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 104 deputetë dhe shpalli të hapur punën e saj.

Në seancën e mëparshme ishte miratuar rendi i ditës i kësaj seance, si vijon:

1. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme;
2. Shqyrtimi i çështjes së kthimit të personave të zhvendosur;
3. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për skemën ndihmës sociale – 2003/16;
4. Shqyrtimi i dytë i P/ligjit për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave – 2003/12;
5. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për shërbime postare – 2003/19;
6. Shqyrtimi i P/rregullorës së UNMIK-ut për Kodin Doganor të Kosovës;
7. Shqyrtimi i Rekomandimit të Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial të Kosovës për emërimin e gjykatësve;
8. Shqyrtimi i propozimit për emërimin e anëtarëve në Bordin për Telekomunikacion;
9. Propozimi për emërimin e një anëtari në Komitetin për bashkëpunim me Tribunalin e Hagës;
10. Parashtrimi i pyetjeve.

1. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme

Deputeti, Naim Maloku pati vërejtje në evidentimin e diskutimit të tij, i cili duhet të korigjohet si vijon: “ në fund tha se AKM-ja duhet të përgjigjet për administrimin

jashtëzakonisht të dobët, jotransparent dhe qeverisjen e dobët të të gjitha ndërmarrjeve publike ose shoqërore dhe çdo raportim që është bërë në KS të OKB-së për ekonominë e Kosovës ka qenë mashtrues”.

Me këtë vërejtje u miratua procesverbali i seancës së kaluar.

2. Shqyrtimi i çështjes së personave të zhvendosur

Kryesuesi e ftoi znj. Pegi Hicks – Drejtoreshë e Zyrës së Komuniteteve dhe të kthyerve në kuadër të UNMIK-ut, që të raportonte para deputetëve të Kuvendit për këtë çështje.

Pegi Hicks tha se çështja e të kthyerve është njëra ndër çështjet kryesore për gjithë popullin e Kosovës dhe të ardhmen e saj.

Kosova respekton të drejtat e të gjithë qytetarëve dhe duhet të mbështes kthimin e të zhvendosurëve, që dëshirojnë të kthehen.

Ne duhet të punojmë së bashku që ta krijojmë këtë vend me standarde evropiane. Dua të flas për progresin që kemi arritur në këtë fushë dhe për sfidat që na presin.

Puna jonë është që ne të sigurojmë që çdo person i zhvendosur që dëshiron të kthehet në shtëpinë e tij, ai mund të kthehet dhe të jetë i sigurtë se të drejtat e tij do të respektohen.

Ne suksesin tonë nuk e gjykojmë thjeshtë përmes shifrave por e shikojmë nga aspekti që njerëzit që duan të kthehen të kenë mundësi punësimi, çasje në shërbime publike, në shëndetësi, në edukim dhe të lëvizin lirshëm.

Numri i personave të zhvendosur është mjaft kundërthënës ngase kemi një shifër mbi 200 mijë të zhvendosur, por sipas regjistrimit të vitit 1999, kjo shifër mund të mos jetë e saktë.

Ka mijëra të zhvendosur që dëshirojnë të kthehen në shtëpitë e tyre dhe atyre duhet t’iu krijojë mundësinë dhe ti shohim kushtet në teren dhe vet të vendosin për të. Disa prej të zhvendosurëve mund të kenë vendosur që dëshirojnë të jetojnë dikund tjetër, ngase e kanë shitur pasurinë e tyre.

Përgjegjësia për kthimin e personave të zhvendosur është e IPVQ-së së Kosovës dhe e UNMIK-ut, por PSSP-ja mban autoritetin që të intervenoj për mbrojtjen e të drejtave të bashkësive. IPVQ-të e Kosovës, tash janë angazhuar në këtë fushë si në nivelin qendror ashtu edhe në atë komunal dhe është shënuar një progres në këtë drejtim.

Përqendrohemi në kthimin e vendit të origjinës, që nënkupton që çdo person i zhvendosur i çdo përkatësie etnike ka të drejtë të kthehet në vendin ku ka jetuar më herët.

Për kthimin e personave të zhvendosur ne kemi themeluar grupet e punës në 28 komuna të Kosovës, të cilat janë të autorizuar për procesin e kthimit. Ato grupe të punës përkrahen nga Qeveria qendrore, ku është formuar grupi i koordinimit të kthimeve që takohet çdo dy javë. Poashtu është themeluar një grup force që kryesohet nga PSSP-ja dhe marrin pjesë komandanti i KFOR-it, kryesuesi i UNHCR dhe Kryeministri i Kosovës.

Ky aktivitet ka dhënë rezultate në fushën e kthimit të personave të zhvendosur ngase në vitin 2002 janë kthyer 2700 persona, kurse në pjesën e parë të këtij viti janë kthyer 1416.

Sa për ilustrim në fshatin Novak të komunës së Prizrenit, janë kthyer 61 familje serbe dhe 44 shtëpi janë duke u rindërtuar. Në fshatrat Biq, Grabac të Klinës janë kthyer 41 familje serbe dhe 20 të tjera janë të gatshme të kthehen.